Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 347/19
Datë/Datum. 15.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **AK-"NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A** OE ankues: **"ESKAVATORI" SHPK"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Teuta Krasniqi - Eksperte profesionale e prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me : **Nr. 347/19 të parashtruar nga "ESKAVATORI" SHPK**		
Datë	15. 07. 2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me:
Ankesën parashtruar me dt:**27.06.2019:me Nr. 347/19 nga "ESKAVATORI" SHPK**

Për shqyrtimin e lëndës **"Furnizim me Asfalt"** me nr te Prokurimit **-1909466981031194-19-3287-1-2-1,** dhe me nr te brendeshem te prokurimit : **019- 020- 121**,e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**AK- "NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A.**
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.
Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktue s – **AK- "NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **ESKAVATORI- SHPK**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesent e parashtruara nga **"ESKAVATORI" SHPK** -lidhur me aktivitetin e prokurimit**"Furnizim me Asfalt"**, me nr te Prokurimit **1909466981031194-19-3287-1-2-1,** dhe me nr te brendeshem te prokurimit : **019- 020- 121**,e e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AK- **"NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A.**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

	05.07.2019	**06.07.2019**	**15.07.2019**
Nënshkrimi i ekspertit	*data e autorizimit të ekspertit.*	*Data e fillimit të ekspertizës*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 27.06. 2019 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **347/19** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Asfalt"** me nr te Prokurimit -**1909466981031194-19-3287-1-2-1,** dhe me nr te brendeshem te prokurimit **019- 020- 121:,- e** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **AK- "NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A.**

Konform nenit 113 dhe nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 të Prokurimit Publik të Kosovës, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK)- **AK- "NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A.**

Operatori Ekonomik Ankues **" ESKAVATORI" SHPK" ANKESA nr. 347/19**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues " **ESKAVATORI" SHPK"** janë:

- Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmby/ljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e përcaktimit të kritereve dhe vendimit nr.prot ZP-02/2019 te dates 19.06.2019 dhe vendimin Nr.prot 03/2019 të datës 21.06.2019, dhe ate kriteri me nr. 9.1 & 9.2 Kërkese mbi mundesite teknike dhe /ose profesionale ka shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së.

1. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethianat faktike që përbëjnë supoziniin për shkeljen e dispozitnve të LPP-së. Ofroni deklarntë të qartë dhe te detajnar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës për rishqyrtini.

OE "Eskavatori" në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik paraqet këtë:

ANKESË KUNDËR VENDIMEVE NR. PROT ZP-02/2019 DHE NR.PROT ZP-03/2019 DHE KRITEREVE TË PËRCAKTUARA ME DOSJEN E TENDERIT

Në fletën e të dhënave të tenderit në fjalë, te pjesa e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 &9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional është përcaktuar se: "Të gjithë OE të cilët dorëzojnë ofertë për këaktivitet të prokurimit duhet të kenë edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej më së largu 30 km, kjo kërkohet për arsye se transportin e asfaltit do ta bëjë vetë NPB.sha me mjete dhe shpenzime të veta. OE që se ka edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej 30km do të eliminohet.

Kundër këtyre kritereve OE "Eskavatori" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK. E njëjta duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim ka marrë vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazë pas vlerësimit me nr.prot ZP-02/2019 dt. 19.06.2019, me të cilën ka konstatuar se kërkesa e tiilë është e pabazuar për faktin se sipas saj ky kriter nuk është diskriminues për faktin se AK Ndërmarrja Banesore do të furnizohet me sasi të vogla të asfaltit dhe kapacitetet tona transportuese janë të kufizuara dhe mund të ndodhë që brenda ditës të ketë deri në 3 apo më shumë raste të transportit të Asfaltit. Sipas saj perimetri prej 30 km nuk e perfshine vetëm Komunën e Prishtinës po edhe disa komuna përreth dhe përvec kësaj ka shumë mundësi që OE të cilët operojnë në peripter më të larfët të bashkëpunojnë përmes formave të lejuara ligjore.

PROVE: Vendimi me nr. ZP-02/2019

Kundër këtij vendimi OE "Eskavatori" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK sipas këshillës juridike të dhënë në vendimin me nr. ZP-02/2019. AK duke vepruar sipas kërkesës për rishqyrtim ka marrë vendim Nr. prot ZP-03/2019 dt. 21.06.2019 me të cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se kemi dhënë përgjigje me arsyeshmëri dhe se mund t'i drejtohemi OSHP-së për më tutje.

PROVE: Vendimi me nr. ZP-03/2019

OE "Eskavatori" konsideron vendimet kontestuse dhe se ky kriter përbën kriter diskriminues, për këtë arsye po paraqet kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit nr. prot ZP -02/2019 dhe ndaj kriterit në fjalë, pasi që të njëjti janë

në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, e që e bën që kjo dosje e tenderit të jetë në kundërshtim me nenin 7 par. 1,2,3,4,dhe6,ku përcaktohet se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3.Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4.Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit: (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Përcaktimi i kriterit që të gjithë OE që tendërojnë në këtë aktivitet të prokurimit duhet të kenë selin në Prishtinë ose jo më largë se 30 km, është kriter diskriminues pasi që i njëjti pamundëson që të gjithë OE të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, kërkesë kjo e nenit 7 par 1 të LPP-së.

Më tutje ky kriter, redukton dhe eleminon konkurrencën mes OE që aplikojnë në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që ky kriter diskriminon në të mirë të OE që e kanë selinë në Prishtinë, dhe në anën tjetër rrjedhimisht diskriminon në dëm të OE që nuk e kanë selinë në Prishtinë, apo e kanë selinë më largë se 30 km. Kjo bën që ky kriter të jetë në kundërshtim të plotë me nenin 7 par. 2 të LPP-së.

Po ashtu, ky kriter është në kundërshtim të plotë edhe me par. 4 të nenit 7 të LPP-së, pasi që me këtë kriter AK është duke imponuar rrethana dhe kushte që rezultojnë me diskriminim territorial ndërmjet OE-ve. Kjo për arsye se ky kriter kufizion konkurrencën vetëm përbrenda territorit të Komunës së Prishtinës, dhe i njëjti u pamundëson të gjithë OE që nuk e kanë selinë në Prishtinë që të tenderojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo përbën rrethanë e cila rezuiton me diskriminim territorial, e që kjo nuk do të duhej të ndodhte pasi që në të kundërtën do të përbënte shkelje të pastër të nenit 7 par.4 të LPP-së.

*K*riteri në fjalë përbën shkelje edhe të par. 6 të nenit 7 të LPP-së, pasi që ky kriter pamundëson piesëmarrjen sa më të gjerë të mundëshme të OE të interesuar. Poashtu, i njëjti është kriter diskriminues në favor të OE që e kanë selinë në Prishtinë dhe në dëm të atyre që e kanë selinë jashtë Komunës së Prishtinës, e që këto bëjnë që të kemi shkelje edhe të par. 6 të nenit 7 të LPP-së.

*Ar*syetimi i AK me vendimin kontestues ZP 02/2019 se ky kriter nuk është diskriminues pasi që të njëjtit do të furnizohen me sasi të vogla të asfaltit dhe kapacitetet tona transportrue jane te kufizuara, konsiderojmë se nuk përbënë arsye që ky kriter të mos jetë diskriminues, pasi që i njëjti zvoglon konkurrencën dhe u mundëson vetëm OE që gjendën në Prishtinë apo Komuna të vogla përrethë, të jenë kandidatë për të fituar këtë tender. Për këto arsye konsiderojmë se AK duhet të eleminoj këtë kriter nga dosja e tenderit dhe të përjashtroj kufizime të tilla diskriminuese. Ne besojmë thellë se pas kësaj kërkese AK do ta trajtoj me kujdes këtë cështje ashtu që të largoj këtë kriter nga Dosja e Tenderit.

Prandaj, i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik që pas pranimit të kësaj ankese të marrë këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e OE "Eskavatori" sh.p.k e parashtruar kundër vendimit me nr. ZP-02/2019 dt. 19.06.2019 dhe vendimit ZP-03/2019 të datës 21.06.2019, si dhe kundër kriterit të përcaktuar në fletën e të dhënave të tenderit në fjalë, te pjesa e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 &9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional ("Të gjithë OE të cilët dorëzojnë ofertë për kë aktivitet të prokurimit duhet të kenë edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej më së largu 30 km), ASHTU QË vendimi nr. ZP-02/2019 i dt. 19.06.2019 dhe vendimi ZP-03/2019 i datës 21.06.2019 ANULOHEN, ashtu që DETYROHET Autoriteti Kontraktues që të eliminoj kriterin e përcaktuar te pjesa e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1&9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional ("Të gjithë OE të cilët dorëzojnë ofertë për kë aktivitet të prokurimit duhet të kenë edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej më së largu 30 km), në tërësi nga Dosja e Tenderit në aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Asfalt", me nr. të prokurimit 1909466981031194-19-3287-1-2-1 ose NPB 019 020 121.

Ferizaj,27.06.2019

OE "Eskavatori" shpk

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....30.05.2019

Lloji i procedurës së aplikuar.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....Punë, vlerë e mesme

Vlera e parashikuar e kontratës ..... totali 115.320,00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 24.06.2019

Data e hapjes së ofertave..... 24.06.2019

Data e Kërkesës për rishqyrtim..... 13.06.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesa 1 Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. (Obligative për të gjithë OE.
Kërkesa 2 Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se OE i ka kryer Obligimet tatimore ose është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Vetëm për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës.
Kërkesa 3 Vërtetim nga Gjykata Ekonomike- që nuk është në procedurë gjygjësore ose i dënuar më parë për vepër penale, vërtetimi jo më i vjetër se tre muaj përpara dorëzimit të tenderit. Vetëm për tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Evidenca 1. Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit
Evidenca 2. Vërtetim nga ATK-ja se nuk ka borxhe ndaj shtetit të Kosovës ose marrëveshjen me ATK, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e shpalljes së tenderit.
Evidenca 3. Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike -(origjinal ose kopje e notarizuar). Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit NPB ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të vendimit të AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të NPB-se për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet , do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe NPB do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit ,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.
Kërkesa 2. Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)
Kërkesa 3. Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Evidenca 1 Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit
Evidenca 2 Kopja e certifikatës së TVSH-së
Evidenca 3 Kopja e certifikatës së numrit fiskal

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, ose grupit të OE-ve gjatë 3 viteve të shkuara që nga data e publikimit të njoftimit për kontratë ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 225.000.000 euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Dëshmia – 1 Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit, për vitin 2019 TM1 (kjo nënkupton se për vitin 2016 ju zbritet TM1) ose Pasqyrat Financiare të audituara nga ndonjë firmë e njohur e licencuar për auditim ose auditor i pavarur i licencuar për tri vitet e shkuara që nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (të bashkangjitet kopja e noterizuar e certifikatës së auditorit) Operatori ekonomik qe përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një, dy apo tri vite ka përmbushur kërkesën minimale te përcaktuar ne dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i

detyrueshëm për t'u kualifikuar.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte (furnizim me asfalt) gjate 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se 165,000.00 euro Të gjithë OE të cilët dorëzojnë ofertë për që aktivitet të prokurimit duhet të kenë edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej më së largu 30 km, kjo kërkohet për arsye se transportin e asfaltit do ta bëjë vetë NPB.sha me mjete dhe shpenzime të veta. OE që se ka edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej 30km do të eliminohet.
Kërkesa 2.Operatori ekonomik duhet te ketë Baze për prodhimin e asfaltit, ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia për Kërkesa 1 Një listë te furnizimeve të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave ose referenca pozitive ose raporti i pranimit teknik) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i liferimit të tillë si dhe deshmia per kryerjen e pageses(transaksioni bankar). Për situatën referuar evidences 1 te pikes 9.2 OE duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në aneksin 8 te DT dhe te bashkëngjesë certifikatat ose referencat positive ose raporti i pranimit teknik përkatës qe evidenton liferimin e tillë.

Dëshmia për Kërkesa 2. Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale ose marrëveshja për furnizim me asfalt me një kompani të licencuar dhe me validitet të licencës.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

OE ankues"*"Companya Eskavatori sh.p.k."* ,, pretendon se Autoriteti Kontraktues ,,Nderrmarja Publike Banesore SH.A., nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë Operatorëve Ekonomik ,

Operatorin ekonomik ankues pretendon se kriteri i vendosur lidhure me vendndodhjen e Selisë së OE. dhe perimetri prej 30 KM.është diskriminues sepse ia pamundëson të ofertojn edhe O.E. të cilët operojn jasht Prishtinës, dhe i favorizon OE. që veprojn në Prishtinë dhe mbi ketë bazë kërkon të eliminohet -heqet ky kriter.

Shih kriterin e vendosur nga AK-së të cilin e konteston OE

Të gjithë OE të cilët dorëzojnë ofertë për këtë aktivitet të prokurimit duhet të kenë edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej më së largu 30 km, kjo kërkohet për arsye se transportin e asfaltit do ta bëjë vetë NPB.sha me mjete dhe shpenzime të veta. O.E. që se ka edhe selinë në Prishtinë ose në perimetrin prej 30km do të eliminohet.

Ekspertja konstaton se ky pretendim nuk qëndron sepse A.K-së e ka shpjeguar me NJ.K. dhe D.T. se transportin e asfaltit do ta bëjë vetë Nderrmarrja Publike Banesore me mjetet dhe shpenzimet e veta , është e drejt dhe obligim i A.K-së. të parashoh se në qfar distance ka mundësi ta transportoj asfaltin,njëkohësisht vendosja e këtij kriteri është në harmoni me nenin 1 dhe 6 të LPP-së . sepse me vendosjen e këtij kriteri A.K.-së sigurohet se do ti zvoglojë shpenzimet e transportit sepse do të furnizohet nga ndonjë OE. që nuk është ma larg se sa 30 KM.,
Sikur mos të vendosej ky kriter A.K-së do detyrohej ta shpërblej me kontratë ndonjë ofertues i cili oferton ndoshta nga vendet ma të largëta por oferton ndoshta vetëm me 1 (një) euro më lirë, pavarësisht selisë se ku gjindet kurse shpenzimet e transporti do ti kushtojën A.K-së

Andaj vendosja e këtij kriteri jo që nuk është diskriminuese por e domosdoshme dhe në harmoni me nenin 7 të LPP-së .

Ekspertja shqtrtuese konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Mendimi dhe shqyrtimi nga ekspertja.

Duke u bazuarë në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese e prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendur të operatorit ekonomik,ta HUDHË POSHT -si të PA BAZUARË (për arsyen që u cekën më lart),dhe i rekomandon panelit shqyrtues që ta lë në fuqi Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.